



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P nr.129/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P., gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurës L. R- B , sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II.nr.354/15 të dt.06.2.2017, për shkak të veprës penale : vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së , pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurës L.R. B dhe të prokurorit të shtetit Muharrem Bajraktari dhe të me dt.08.11.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

A K T G J Y K I M

E pandehura L. B mbiemri i vajzërisë R, e lindur me dt.06.3.1985 në P. , me vendbanim në P. lagja ... rruga Sami Frashri nr. 15, e bija N dhe nënës E e gjinisë S , shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTORE

Për arsye se :

Me dt. 27.11.2014 në shtëpinë e saj në rrugën S.F nr. 15 , lagja Komuna e P. , pa autorizim të furnizimit të autorizuar ka përfutur shërbime komunale përmes rrjetit të energjisë elektrike , në atë mënyrë që ditën kritike përgjatë kontrollit që kanë bërë komisioni i autorizuar i KEDS-it , Distribucioni në P. është konstatuar se e pandehura është kyçur pa njehsor , me ç’ rast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëmin material .

-me çka ka kryer veprë penale: vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KKPR-së

Prandaj gjykata të pandehurin konform nenit 41, 42,43,46 ,49 ,50,51,52, 76 dhe nenit 320 të KPRK-së.

E GJYKON :

Me dënim me gjobë në lartësi prej 200 euro , e të cilën gjobë e pandehura fare nuk do ta paguaj nëse në afat prej 1(një)viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale . Dhe :

Me dënim të kushtëzuar burgu,

1. Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 3 muajsh , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale

E pandehura për shkak të gjendjes ë varfër ekonomike lirohet nga pagesa e paushallit gjyqësor .

E dëmtuara për realizimin eventual e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzime procedurale nuk ka pasur

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.06.2.2017 kundër të pandehurës L. R. B ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.354/15, për vepër penale: vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së , duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurën ta shpallë fajtores , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestar e pandehura – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasoja e pranimit përkatësisht të mos pranimit të fajësisë- e ka pranuar fajësinë. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit, i bindur se pranim fajësinë e pandehura e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe asnjë mënyrë e ka pranuar.

Meqenëse e pandehura e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e singertë të fajësisë, pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, më parë nuk ka qenë e gjykuar, faktin se pandehura është e gjendjes së varfër ekonomike por edhe faktin se bashkëshortin e ka të pa punë, dhe kësiaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurës do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 453 të KPPRK-së

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform nenit 463 të KPPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.08.11.2017

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet

Ankesa në afat prej 15 ditësh nga

Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë

E përmes kësaj Gjykate .